

05-01-2018

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM -**  
 DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me sekretaren juridike Ardrita Imeri, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1874-6/17 të datës 20.11.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.18.12.2017 solli:

### AKT GJYKIM

**APROVOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1874-6/17 të datës 20.11.2017 dhe gjykata jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, i lindur me datën [REDAKTUAR], në Prishtinë nga i ati [REDAKTUAR], dhe e ëma [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personale të letërnjoftimit [REDAKTUAR] mbrohet në liri,

### ËSHTË FAJTOR

*Sepse* - me datën 06.09.2017, rreth orës 09:20, në rrugën magjistrale Kaçanik-Ferizaj në afërsi të fshatit Gërlicë, duke drejtuar automjetin, e markës " VW Passat 3 C ", ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], nga pakujdesia e në kundërshtim me dispozitat e nenit 53.1 të LSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që ka ndërmarrë veprim jo të sigurt dhe të pakujdesshëm që të kthehet tek rruga nën urë, ashtu që me pjesën e parë të anës së majtë gjegjësisht me mbrojtësin e rrotës dhe pasqyrën e majtë të automjetit e godet në këmbën e djathtë këmbësorin [REDAKTUAR], i cili ishte duke e udhëzuar një vozitës të kamionit që të kthehet në këtë vend me ç'rast nga kjo goditje i dëmtuari pëson, lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 15.10.2017,-.

*- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së*

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

### DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88Euro dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1874-6/17 të datës 20.11.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR], me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe në aktakuzë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i dt.15.10.2017, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 07.11.2017, deklarata e të pandehurit dhënë në prokurori me dt.09.10.2017, deklaratat e të dëmtuarit dhënë në prokurori me dt.09.10.2017, Raporti mjekësor nga Qendra Emergjente në Ferizaj e datës 06.08.2017, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3 të KPPK-së, të dëmtuarin [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL  
P.nr.2987/2017 i dt.18.12.2017

**Sekretarja juridike**  
Ardrita Imeri



### UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.